

Teuta SHALA

AKTIVITETET E INSTITUTIT TË HISTORISË TË PRISHTINËS GJATË VITIT 2005

Duke filluar që nga korriku 2005 e deri në dhjetor të po këtij viti Instituti i Historisë në Prishtinë, krahas projekteve dhe angazhimeve të shumta, organizoi tri simpoziume dhe një tribunë shkencore. Në to u ofruan të dhëna me interes për ngjarje të rëndësishme dhe figura të ndritura të historisë sonë. Më poshtë po japim një pasqyrë të shkurtër për rëndësinë e secilit prej këtyre simpoziumeve dhe tribunës.

Instituti i Historisë-Prishtinë në bashkëpunim me Institutin e Historisë- Tiranë, më 8 korrik 2005 organizuan në Gjakovë Simpoziumin shkencor **“Bajram Curri figurë e shquar e Lëvizjes Kombëtare dhe Demokratike”**. Në simpozium u lexuan 11 kumtesa, ndërsa atë e hapi **Dr Jusuf Bajraktari**, drejtor i Institutit të Historisë-Prishtinë. Më pas Simpoziumin e përshëndetën: përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, **z. Defrim Gashi**, si dhe kryetari i Kuvendit të Komunës së Gjakovës, **z. Aqif Shehu**.

Punimet e tyre në këtë simpozium i lexuan: **Dr. Zekeria Cana** (Prishtinë) “Bajram Curri figurë e shquar e Lëvizjes Kombëtare”; **Prof. Dr. Muin Çami** (Tiranë) ”Figura e Bajram Currit në historiografinë shqiptare”; **Dr. Jusuf Bajraktari** (Prishtinë) “Figura e Bajram Currit sipas biografit Niman Ferizi”; **Sokol Gjermani** (Tiranë) “Aspekte të veprimtarisë së Bajram Currit në Kryengritjen e vitit 1912”; **Prof. Dr. Bardhosh Gaçe** (Tiranë) “Marrëdhëniet e Bajram Currit me Vlorën”; **Isuf Sadiku** “Malësia e Gjakovës mbështetje kryesore e Bajram Currit”; **Prof. Dr. Fatmira Musaj** (Tiranë) “Kontributi i Bajram Currit në Lëvizjen Demokratike të vitit 1924”.

Për vendin që zë figura e Bajram Currit në tekstet shkollore të historisë referoi **Mr. Frashër Demaj** (Prishtinë), ndërsa për “Personalitetin e Bajram Currit në frymën e rivlerësimeve historike” **Dr. Izber Hoti** (Prishtinë).

Në simpozium përveç historianëve morën pjesë edhe studiues nga fusha e artit dhe e letërsisë. **Piktori i merituar Kujtim Buza** (Tiranë) u paraqit me temën “Bajram Curri në disa vepra të artit figurativ”, ndërsa nga fusha e letërsisë u paraqit **Prof. Dr. Rifat Ismaili** (Prishtinë) me temën “Figura e Bajram Currit në letërsi”.

Në fund të pranishmit trajtuan probleme të ndryshme rreth figurës së Bajram Currit dhe për disa paqartësi rreth termit revolucion i vitit 1924.

Pas diskutimeve **Prof. Dr. Marenglen Verli**, drejtor i Institutit të Historisë-Tiranë mbajti fjalën e mbylljes.

Më 30 shtator 2005 Instituti i Historisë në Prishtinë organizoi Simpoziumin shkencor “**Kosova në Luftën e Dytë Botërore**”, kushtuar 60- vjetorit të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Në Simpozium me kumtesa u paraqitën 16 studiues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia. Simpoziumin e hapi **Dr. Jusuf Bajraktari**, Drejtor i Institutit të Historisë në Prishtinë e më pas tubimin e përshëndeti përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, **z. Fehmi Ismaili**.

Referatat e tyre në Simpozium i lexuan: **Prof. Dr. Muhamet Shatri** (Prishtinë) “Specifikat e LNÇ-së në Kosovë”; **Prof. Dr. Xhelal Gjeçovi** (Tiranë) “Çështja kombëtare shqiptare në vitet e Luftës së Dytë Botërore; **Prof. Dr. Fehmi Rexhepi** (Prishtinë) “Lufta e shqiptarëve për çlirim e bashkim kombëtar në vitet e Luftës së Dytë Botërore; **Vehap Shita** (Prishtinë) veteran i LANÇ-së “Aspiratat për çlirimin kombëtar i tubuan shqiptarët (e Kosovës) në anën e Bllokut Antifashist”; **Prof. Dr. Ramiz Abdyli** (Shkup) “Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore”; **Prof. Dr. Beqir Meta** (Tiranë) “Problemi i Kosovës dhe i Çamërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore”; **Prof. Dr. Izber Hoti** (Prishtinë) “Arsyet dhe përmasat e nazifashizmit në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore”; **Prof. dr. Muharrem Dezhgiu** (Tiranë) “Çështja e legjimitetit të shtetit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore”; **Dr. Jusuf Bajraktari** (Prishtinë) “Konferenca e Bujanit- ndikimi i saj në përcaktimin e shqiptarëve të Kosovës për LANÇ”; **Akademik Minir Dushi** (Prishtinë) “Fadil Hoxha dhe Konferenca e Bujanit”; **Prof. Dr. Marenglen Verli** (Tiranë) “Dështimi i përpjekjeve për shndërrimin e Kosovës në një rezervë ushtarake të Wermahitit”; **Uran Butka** (Tiranë) “Lëvizja Kryeziu-alternativë e mundshme për çlirim dhe bashkim kombëtar”; **Isuf Imeraj** veteran i LNÇ-së (Tiranë) “Forcat nacionaliste të Bytyçit nën Drejtimin e Kryezive”; **Akademik Pajazit Nushi** (Prishtinë) “Të Drejtat njerëzore dhe synimet politike të shqiptarëve të Kosovës në Luftën e Dytë Botërore”; **Prof. Dr. Sabile Keçmezi-Basha** (Prishtinë)

“Reagimi i forcave nacionaliste ndaj vendimeve të Kuvendit të Prizrenit (8-10 korrik 1945)”, **Prof. Dr. Haki Kasumi** (Prishtinë) “Të internuarit e Kosovës në kampet nazifashiste”.

Pas diskutimeve fjalën e mbylljes në Simpozium e mbajti **Prof. Dr. Marenglen Verli**, drejtor i Institutit të Historisë në Tiranë.

Në nëntor të vitit 2005 Instituti i Historisë në Prishtinë, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut organizoi Simpoziumin shkencorë me karakter ndërkombëtar “**Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe epoka e tij**”.

Në këtë Simpozium u lexuan 22 kumtesa. Ishte paraparë që në punimet e këtij tubimi shkencor me rëndësi të merrnin pjesë edhe studiues të huaj, disa prej të cilëve në pamundësi për të ardhur kishin dërguar kumtesat me shkrim, të cilat u lexuan nga punëtorët e Institutit të Historisë i Prishtinës.

Fjalën e hapjes e mbajti **Akademik Rexhep Ismaili**, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Në emër të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë tubimin e përshëndeti **Prof. Dr. Marengelen Verli**, drejtor i Institutit të Historisë-Tiranë, pastaj këshilltari i presidentit të Kosovës **z. Sali Ccaj**, si dhe ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, **z. Agim Veliu**.

Në Simpozium lexuan kumtesat e tyre **Prof. Dr. Jusuf Bajraktari** “Figura e Skënderbeut në historiografinë e Kosovës”; **Prof. Dr. Ferid Duka** (Tiranë) “Fisnikëria shqiptare dhe lufta e Skënderbeut”; **Prof. Dr. Oliver Schmith** (Vjenë) “Skënderbeu-strukturat e një qeverisjeje në mesjetën e vonë”; Për Kastriotët në Dardani referoi **Prof. Dr. Kasem Biçoku** (Tiranë), Për rolin e Skënderbeut në ndërtimin e identitetit nacional shqiptar studiuesja nga Stambolli **Prof. Dr. Nuray Bozbor**a; Studiuesi nga Budapeshti **Prof. Dr. Istfan Schütz** referoi temën “Raportet e Skënderbeut me Huniadin”; **Prof. Dr. Selim Daci** “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu kryendërtues i Besëlidhjes së Lezhës”; **Prof. Dr. Pajazit Nushi** “Trajtimi enciklopedik i Skënderbeut”; Për jehonën e veprës së Barletit në Francë referoi **Prof. Dr. Ymer Jaka**, kurse **Prof. Dr. Iljaz Rexha** paraqiti kumtesën “Skënderbeu sipas kronikave osmane të shek XV-XVI”

Studiuesi nga Palermo **Chiarmonte** u paraqit me kumtesën “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në jetën dhe kulturën e Sicilisë”, ndërsa **Piktori i merituar Kujtim Buza** (Tiranë) me kumtesën “Skënderbeu ne monumente”. Për vendin që heroi ynë zë në historiografinë bullgare ofroi të dhëna **Prof. Dr. Sergey Roussev**, studiues nga Sofja në kumtesën

“Figura e Skënderbeut në historiografinë bullgare”; Për marrëdhëniet e Skënderbeut me Alfonsin V referoi **Mr. Mark Gjokaj** (Ulqin); **Prof. Dr. Enes Pelidija**, studiues nga Sarajeva, paraqiti kumtesën “Skënderbeu në historiografinë boshnjake”, ndërsa **Don Frrok Zefi** (Zagreb) në kumtesën e tij “Skënderbeu në literaturën kroate” ofroi informacione për vendin që Gjergj Kastrioti-Skënderbeu zë në këtë literaturë; “Skënderbeu sipas Pulevskit” ishte kumtesa të cilën e lexoi **Prof. Dr. Ramiz Abdyl** (Shkup); studiuesja nga Tirana **Prof. dr. Klara Kodra** kumtesën “Skënderbeu në veprën e De Radës, Gabriel Darës dhe Skiroit”; **Dr. Fehmi Rexhepi** kumtesën “Skënderbeu në tekstet e historisë së Kosovës”, ndërsa **Dr. Lulëzim Lajçi** (Prishtinë) “Skënderbeu dhe Lufta e Dytë e Kosovës”. Simpoziumi u mbyll me kumtesën e Ismajl Dodës (Ulqin) “Skënderbeu në traditën popullore shqiptare në Mal të Zi”, ndërkaq fjalën e mbylljes e mbajti **Dr. Jusuf Bajraktari** drejtor i Institutit të Historisë Prishtinë.

Instituti i Historisë-Prishtinë në bashkëpunim me Fakultetin e Studimeve Islame-Prishtinë, me rastin e 200-vjetorit të ardhjes në pushtet të Mehmet Ali Pashë-Misirit, organizoi në Prishtinë më 5 dhjetor 2005 Tribunën shkencore “Mehmet Ali Pasha-Themeluesi i Egjiptit Modern”.

Fjalën e hapjes në këtë Tribunë shkencore e mbajti Dr. Jusuf Bajraktari, drejtor i Institutit të Historisë në Prishtinë, ndërsa u lexuan 6 kumtesa. Kumtesën “Mehmet Ali Pasha figurë e shquar e historisë moderne “ e paraqiti **Dr. Jusuf Bajraktari** (Prishtinë), **Mr. Qemajl Morina** (Prishtinë) kumtesën “Dinastia shqiptare e Egjiptit”; Studiuesi nga Baku **Mr. Shemsi Ajvazi** referoi në temën “Mehmet Alia ndërtues i civilizimit”. Për figurën e Mehmet Ali Pashës te autorët anglezë të shek.XIX referoi **Prof. Dr. Gazmend Riza** (Prishtinë). **Nehat Islami** (Prishtinë) paraqiti kumtesën “Mehmet Ali Pasha në letërkëmbimin diplomatik francez”, ndërsa **Driton Tali** “Mehmet Ali Pasha lider shteti”.

Përveç të dhënave për jetën e Mehmet Ali Pashë-Misirit, kumtesat e paraqitura në këtë Tribunë shkencore ofrojnë informacione edhe për rolin që ai luajti në reformimin e Egjiptit dhe për kontributin që dha në ndërtimin e civilizimit në Egjipt. Kumtesat në fjalë hodhën dritë mbi jetën dhe veprën e Mehmet Ali Pashë-Misirit, duke e radhitur atë në mesin e figurave më të shquara të historisë moderne.

Fjalën e mbylljes në këtë Tribune e mbajti **Mr. Qemajl Morina**, prodekan i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë.

INSTITUTI I HISTORISË – PRISHTINË

KOSOVA

28
2006

Redaktor gjuhësor
Hysen Kadriu

Rezimetë i përktheu
Kreshnik Bajraktari

Përgatitja kompjuterike
Bekim Aliu

Tirazhi: 500 copë

Botimin e kësaj reviste e financoi
Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë

